



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 08.09.2023, të parashtruar nga Operatori ekonomik Roza Komani B.I., për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i çerdhes në Rogovë”, me Nr. të Prokurimit: 632-23-7376-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-23-109-521, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e** bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik Roza Komani B.I.e dt.08.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes në Rogovë”, me Nr. të Prokurimit: 632-23-7376-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-23-109-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 05.09.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Anullohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 05.09.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.08.09.2023, Operatori ekonomik Roza Komani B.I., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Ndërtimi i çerdhes në Rogovë”, me Nr. të Prokurimit: 632-23-7376-5-2-1, Nr. Brendshëm 632-23-109-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja janë pjesërisht të bazuara, prandaj Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së , **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ktij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës